

L I G J
Nr.8236, datë 28.8.1997

**PËR DISA NDRYSHIMË NË LIGJIN NR.7597, DATË 31.8.1992 "PËR SHËRBIMIN E
KONTROLLIT TË SHTETIT"**

Në mbështetje e neneve 16 dhe 23 ëligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 2 shtohet njëparagraf me këtë përmbajtje:

"Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit caktohet një përfaqësues nga radhët e opozitës. Përtëritja e mandatit të kryetarit dhe zëvendëskryetarëve bëhet në përputhje me atë të Kuvendit Popullor."

Neni 2

Paragrafi i parë i nenit 12 ndryshohet si vijon: "Kryetari dhe zëvendëskryetarët e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit emërohen nga Kuvendi Popullor me propozim të Presidentit të Republikës."

Neni 3

Paragrafi i dytë i nenit 14 shfuqizohet.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij.

Shpallur me dekretin nr.1884, datë 29.8.1997, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani